REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 851 /20
Datë/Datum. 04.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Naser Fejzullahu ***Ekspert Shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***26.10.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***04.11.2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23 tetor **.2020, OE "N.T.SH. M.S.MEDIKOM"B.I**, ka parashtruar ankesë me nr: 851/**20**, kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Funizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajërit"** me nr. të prokurimit: **21432700-20-4902-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia e Menaxhimit Emergjent.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: FURNIZIM, vlera e parashikuar e kontratës: **800,00,00 € vlere e madhe.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 02.09.2020 , data e hapjes së ofertës 30.09.2020, data e njoftimit për dhënien e kontratës 08.10.2020, data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm 08.10.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Vendimi per refuzimin si te pabazuar te Kerkeses per Rishqyrtim te OE "M.S. Medicom" eshte vendim i kunderligjshem dhe ne shkelje te rende te Ligjit nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, sikurse eshte amandamentuar (tutje referuar si **"Ligji i Prokurimit"**). Si i tille, Vendimi ne fjale diski'iminon OE "M.S. Medicom" dhe i shkele parimet bazike te Ligjit te Prokurimit.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve - Ofertat e paraqitura nga OE i rekomanduar per Kontrate dhe OE te tjere jane te papergjegjshme dhe nuk perputhen me kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit dhe ne LPP. Ne anen tjeter, Oferta e OE "M.S. Medicom" eshte e vetmja oferte e pergjegjshme si dhe me qmimin me te lire.

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi - shperblimi me kontrate i OE i cili nuk i permbush kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit, i diksriminon OE te pergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit.
Neni 10 - Mjetet per promovimin e Transparency - OE Ankues i eshte refuzuar qasja ne dokumentet e aktivitetit tenderues, me saktesisht ne dosjen e operatorit te rekomanduar permes te cilit percaktohet nese ai eshte i pergjegjshem apo jo.
Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste - Informatat te cilat lidhen me Certifikata e produkteve dhe pergjegjshmerine e tyre nuk mund te klasifikohen si informata sekrete afariste. Edhe ne rast se pjese te tyre do klasifikoheshin si informata sekrete, AK ka qene i obliguar qe te pergatise nje version i cili i paraqet te dhenat e dokumentit ne menyre te pergjithshme dhe duke fshehur pjesen e sekretetit. Kjo ne perputhje me paragrafm 3 te Nenin 11.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasitetit - permes interpretimit diskriminues te Dosjes se Tenderit. AK dhe Buxheti i Republikes se Kosoves demtohen duke mos e shperblyer me Kontrate OE me te favorshem.

A. OE I REKOMANDUAR PER KONTRATE N.T.P. "DARDANI X" ESHTE I PAPERGJEGJSHEM

Papergjegjshmeria e OE te rekomanduar per Kontrate eshte percaktuar ne baze te vleresimit te mostrave te dorezuara ne perputhje me kerkesat e Dosjes se Tenderit.
Oferta e ketij OE nuk i permbushe kriteret esenciale lidhur me sistemin e mbajtjes, cilindrit te ajrit dhe maskes, te cilat jane percaktuar nga AK. Keto kritere, nder te tjera, perfshijne: qe rrypat e shpatullave te jene te punuar nga materiali aramid, aprovimi EN 14593, standardi MED 2014/90/EU, shenimet dhe deshmite lidhur me rezistencen e rrypave ndaj shpimit, kimikateve, gerryerjes, apo per mekanizmin paralajmerues te matesit te presionit ose manometrit, si dhe qe rnaska apo trupi i maskes te jete me dy shtresa te dyfishta izoluese - si kriteri me i rendesishem ne kete specifikacion, e te cilin OE Dardani X nuk e ploteson pasi qe ka ofruar maske me vetem nje shtrese izolimi nuk ofron siguri te mjaftueshme per levizje te kokes.
Ne kete drejtim, OE ne ljale duhet te eliminohet nga aktiviteti i prokurimit pasi qe i njejti nuk i permbushe kriteret esenciale qe kerkohen per kete aktivitet te prokurimit si dhe per faktin se ka ofertuar me pmim tejet te larte.

Me konkretisht, ne tabelen ne vijim kemi paraqitur Specifikat teknike te kerkuara nga AK (ne anen e majte) dhe oferten e dorezuar nga OE N.T.P. "Dardani X" (ne anen e djathte):

		Interspo Spiromatic 90 U	Pasojat qi rrjedhin nga dallimet ne mes te produkteve te kerkuara dhe atyre te ofruara
	Sistemi I mbajtjes		
1.1	Rripat e shpatullave duhet te jane rezistente ndaj gerryerjes dhe shpimit, te jene rezistent ndaj kimikateve dhe te jene rezistent ndaj zjarrit.	Duke u bazuar ne broshuarat e prodhuesit, te paraqitura ne web-faqe, rrypat nuk jane rezistent ndaj gerryerjes, shpimit dhe materieve kimike apo acideve.	Ne rast rast se rrypat nuk sigurojne rezistencen e kerkuar, te njejtit mund te keputen lehte apo te shkaterrohen ose pelcasin nga acidi, dhe ne kete menyre rrezikojne jeten e personave qe i bartin keto pajisje.
1.2	Matesi i presioni ose Manometri duhet te jete i struktures luminescente per t'i lejuar perdoruesit te monitorojne presionin ne hapesirat e erreta. Matesi i presioni te kete nje mekanizem paralajmerimi ne rast se presioni i brendshem i cilindrit bie ne 50 ± 5 bar.	Nuk posedon shenime ne katalogun e prodhuesit qe matesi i presionit eshte lumeniscent. Nuk posedon shenime ne katalogun e prodhuesit ne pfare presioni paralajmeron ne rast se presioni i brendshem i cilindrit bie ne 50 ± 5 bar.	Ne rast se matesi i presionit nuk eshte lumeniscent, perdoruesve do t'iu pamundesohet monitorimi i presionit ne hapesira te erreta. Ne rast se matesi i presionit nuk paralajmeron kur presioni bie ne 50 bar apo me pak, atehere perdoruesi nuk mund te kete kohe te mjaftueshme per evakuaim, dhe kjo dukuri mund te shkaktoje vdekjen e zjarrfikesit.
1.3	Presioni nominal i fazes se pare: 7.5 bar	Nuk ka shenime.	Presioni nominal eshte te jete i rendesishem qe reduktimi nga 300 ne ~ afersisht 1 bar te jete i pershkallezuar. Ne rast se deshton reduktuesi i presionit te larte, mushkria automatike te jete preventive.
1.4	• Rrjedhja e mushkrise automatike: 400 l/min	k ka shenime per rrjedhjen e mushkerise.	Nese rrjedhja eshte me e ulet se sa eshte kerkuar nga AK, perdoruesi mund te kete veshtiresi ne frymemarrje.
1.5	Zhurma e filikaqes, minimum: 90 decibel -dBA	Nuk ka shenime.	Neese zhurma eshte me e ulet, perdoruesi rrezikohet te mbetet pa ajer rezerve per vete-evakuim dhe mund t'i kushtoje me jete.
1.6	EN 136:1998; EN 14593 (MED) 2014/90/EU.	Nuk posedon aprovimin EN 136 (1998). Nuk posedon aprovimin EN 14593. Nuk dihet cilin MED standard posedon.	Nestet laboratorike dhe praktike te performances jane perfshire ne vleresimet e perputhshmerise se ketyre kerkesave. Aprovimi EN 136 (1998) specifikon kerkesat minimale te maskes. Ne rast se maska nuk posedon aprovimin EN 136, atehere maska nuk mund te perdoret si pajisje mbrojtëse profesionale.

2.1	**Maska e Ajrit** et te jete i pajisur me valvule sigurie te rrjedhes se tepert. ete rezistent ndaj goditjeve, substancave ike dhe i lehte per tu pastruar.	**nsilc Tediiirnl System** uk posedon shenime qe posedon valvule sigurie te rrjedhes se tepert. uk posedon shenime qe eshte rezistente ndaj goditjeve dhe substancave kimike.	**Pasojat qe i rjedhiu uga dallimel produkteve te kerkuara dhe te ofruara** Mungesa e valvules se sigurise te rrjedhes se tepert rrezikon jeten e perdoruesit dhe personave afer tij, si dhe ule koston e bomboles. • Mos-rezistenca ndaj goditjeve substancave kimike ndikon qe cilindri te pelcase nga acidi gje qe mund te shkaktoje vdekjen e onave perreth. Po ashtu, ne mungese te kesaj mbrojtje, cilindri ka kosto me te ulet.
	zgjatja e punes minimum: 0 minuta.	posedon shenime ne adresen zyrtare te internetit te prodhuesit.	

Ne anen tjeter, per OE N.T.P. "Dardani X", OE Ankues lea paraqitur kerkese per qasje ne dokumentet tenderues, e cila

eshte aprovuar nga AK vetem sa i perket Ofertes Financiare, me arsyetimin se dokumentet e tjera paraqesin sekrete afariste. Ne kete drejtim, ne paragrafin e meposhtem kemi sqaruar rastet se kur mund te klasifikohen dokumentet si informacione sekrete afariste, sipas legjislacionit ne fuqi.

1. **Per dokumentet qe cilesohen si informacione sekrete afariste, AK duhet te pergatise versionin e pastruar, ne te cilin mund te kene qasje OE te tjere**

Bazuar ne kerkesen e OE N.T.P. "Dardani X", AK ka klasifikuar te gjitha informacionet e ofertes se ketij OE si Informacione Sekrete Afariste. Te vetmin informacion te cilin AK e ka lejuar si dokument ku lejohet qasja ka perfshire Oferten Financiare.

Per shkak se ka dyshime te bazuara se OE ne fjale nuk i ploteson kerkesat e Dosjes se Tenderit, kjo ne raport me certifikatat e kerkuara me Dosje te Tenderit, Autorizimet dhe specifikimin teknik, OE Ankues ka kerkuar qasje ne dokumentet tenderuese te OE ne fjale. Kjo qasje eshte lejuar vetem ne oferten financiare dhe eshte refuzuar per dokumentet e tjera tenderuese.

Dyshimi bazohet ne mostrat e dorezuara nga OE N.T.P. "Dardani X", e te cilat OE Ankues i ka pare me rastin e dorezimit te ofertes se tij.

Dokumentet ne lidhje me pergjegjshmerine e Operatoreve Ekonomik, kjo lidhur me Nenin 59 per Ekzaminimin, Vleresimin dhe Krahasimin e Tendereve, nuk mund te klasifikohen asnjehere si Informacione Sekrete Afariste. Kjo pasi qe nje klasifikim i tille do e bente teresisht te pakuptimte tere legjislacionin e prokurimit publik dhe parimin e transparences.

Per shumicen e produkteve ne Dosjen e Tenderit jane kerkuara CE Certifikata dhe Certifikatat e Konformitetit, dhe perputhje me Standardet ISO. Ka dyshime se per OE N.T.P. "Dardani X" nuk i plotesojne kushtet e Dosjes se Tenderit, kjo per shkak se i mungojne Certifikata e kerkuara dhe/ose autorizimet.

Nje Kerkese per Informacion Sekret Afarist ne asnje rrethane nuk lejohet te perfshije tere dokumentet tenderuese, por Kerkesa duhet te jete ne lidhje me nje dokument specifik dhe ne lidhje me te dhena specifike te cilat mbrohen. Kerkesat

gjenerale duhet te refuzohen ne menyre automatike nga AK.

Fakti se OE ka paraqitur Kerkese per te klasifikuar nje dokument te tenderit si Sekret Afarist, nuk e bene informacionin sekret. Lidhur me Kerkesen, AK duhet te vendose me Vendim te vegante me shkrim, nese e njejta - Kerkesa - i ploteson kushtet ligjore per f u trajtuar si informacion sekret, te cilat njedhin nga Neni 11, paragrafi 3, i LPP-se.

Kushtet qe nje informacion te trajtohet si Sekret Afarist jane te detajuara dhe, nder te tjera, duhet te kete arsyetim te detajuar si dhe prova se publikimi i nje informacioni te tille shkakton dem.

Ne rast se AK vendose qe nje dokument i caktuar, specifikisht i identifikuar, permban Informacion Sekret Afarist, atehere, ne baze te paragrafit 4 te Nenit 11 te LPP-se, duhet te pergatise versionin e "pastruar" te atij dokumenti. Kjo duke e pastruar vetem Informacionin Sekret Afarist dhe duke e lene tere dokumentin tjeter per inspektim. Neni 11, paragrafi 4, i LPP- se, percakton qe:

"Autoriteti kontraktues qe e ka klasifikuar nje element te informates si informate sekrete afariste sipas paragrafit 3. te ketij neni, do te pergatit versionin e "pastruar" te qdo dokumenti, nese elementi i tille gjendet ne dokumentin ne te cilin po ashtu gjendet informacioni qe nuk konsiderohet te jete sekret. Versioni i tille ipastruar duhet te perfshihet ne materialin ne te cilin ka qasje publiku dhe palet e interesuara sipas nenit paragrafit 3. "

AK pretendon se ka pergatitur versionin e pastruar te dokumenteve te cilat jane cilesuar si sekrete afariste dhe se ka krijuar hapesire per qasje ne te njejtat per te gjithe OE te interesuar. Megjithate, OE Ankues nuk ka pasur qasje ne versionin e pasturar - kjo pasi qe te njejtat nuk jane publikuar asnjehere nga AK, dhe po ashtu, AK nuk ka publikuar as Vendimin lidhur me cilesimin/klasifikimin e dokumenteve si sekrete - siq kerkohet ligjerisht.

Andaj, ne rast se AK ka marre Vendim qe ndonje dokument te dosjes se kerkuara ta cilesoje si sekret, OE Ankues kerkon nga i njejti qe te tregoje specifikisht se cilat dokumente AK i ka pranuar si sekrete dhe t'ia dergoje versionin e pastruar te te njejtave. Ne te kunderten, AK do te shkelte Nenet 10, 11 dhe 59 te LPP-se.

PRETENDIMI ANKIMOR 2:

A. OFERTA E OE "ALBKOS SAFETY" NUK IPERMBUSHE SPECIFIKACIONET TEKNIKE TE PERCAKTUARA NE DOSJEN E TENDERIT

Pas qasjes ne dokumentet tenderuese te OE "Albkos Safety", OE Ankues ka verejtur se i njejti nuk i permbushe kriteret lidhur me specifikacionet teknike te percaktuara si ne Ankesin 1 te Dosjes se Tenderit.

Oferta e OE ne fjale nuk i permbushe kriteret kryesore lidhur me sistemin e mbajtjes, cilindrit te ajrit dhe maskes, te cilat jane percaktuar nga AK. Keto kritere, te tilla si: aprovimi EN 14593, standardi MED 2014/90/EU, shenime dhe deshmi lidhur me rezistencen e rrypave ndaj shpimit, kimikateve, gerryerjes, apo per mekanizmin paralajmerues te matesit te presionit ose manometrit, izolimi i dyfishte ne trupin e maskes, jane kritere esenciale per produktet qe kerkohen ne kete aktivitet te prokurimit.

Rrjedhimisht, duke mos i permbushur te njejtat - kriteret esenciale -, si dhe duke marre parasysh qmimi me te cilin ka ofertuar, rezulton qe OE ne fjale eshte i papergjegjshem dhe i njejti duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Me konkretisht, ne tabelen ne vijim kemi paraqitur Specifikat teknike te kerkuara nga AK (ne anen e majte) dhe oferten e dorezuar nga OE "Albkos Safety" (ne anen e djathte):

Me konkretisht, ne tabelen ne vijim kemi paraqitur Specifikat teknike te kerkuara nga AK (ne anen e majte) dhe oferten e dorezuar nga OE "Albkos Safety" (ne anen e djathte):

	Specifikimi teknik i Autoritetit Kontraktues	Specifikimi teknik i Operatorit Ekonomik	
	Sistemi I Mbajtjes	Fenzy Aeris Type 2	asojat qe rrjedhin nga dallimet ne mes te produkteve te kerkuara dhe te ofruara
1.1	® Rripat e shpatullave duhet te jene rezistente ndaj gerryerjes dhe shpimit; te jene rezistente ndaj kimikateve dhe ndaj zjarrit.	Duke u bazuar ne broshuarat e prodhuesit ne web-faqen, dhe jo ne deklaratat e manipuluara nga OE, rrypat nuk jane rezistent ndaj gerryerjes, shpimit dhe materieve kimike apo acideve.	Ne rast se rrypat nuk sigurojne rezistencen e kerkuar, te njejtit mund te keputen lehte apo te shkaterrohen ose pelcasin nga acidi, dhe ne kete menyre rrezikojne jeten e personave qe i bartin keto pajisje.
2	• Matesi i presioni ose Manometri duhet te tregoje sasine e presionit brenda ndrit (bomboles), te kete nje mekanizem paralajmerimi ne rastse presioni i brendshem i cilindrit bie ne 50 ± 5 bar.	® Nuk ka shenime ne ffare presioni paralajmeron ne rast se presioni i brendshem i cilindrit bie ne 50 ± 5 bar.	® Ne rast se matesi i presionit nuk paralajmeron kur presioni bie ne 50 bar, atehere perdoruesi nuk mund te kete kohe te mjaftueshme per evakuaim, dhe kjo dukuri mund te shkaktoje vdekjen e zjarrflkesit.
3	• Pesha maksimale: 2.20 - 3.70kg	• Nuk ka shenime per peshen ne katalogun e prodhuesit.	
4	• Dimenzionet maksimale (H x W x D): (590 - 630) x (280 - 410) x (70-220) mm	Nuk ka shenime per dimensione ne katalogun e prodhuesit.	
5	Presioni nominal i fazes se pare: 7.5 bar	• Nuk ka shenime ne katalogun e prodhuesit.	® Presioni nominal eshte tejet i rendesishem qe reduktimi nga 300 ne ~ afersisht 1 bar te jete i pershkallezuar. Ne rast se deshton reduktuesi i presionit te larte, mushkeria automatike te jete preventive.
6	• Rrjedha e fazes se pare: (me shume se) 1350 1/min. **Mund te jete edhe nen 13501/min dhe jo me pak se 10001/min.**	uk ka shenime per rrjedhjen e fazes se pare.	e rrjedhja eshte me e larte, bombola nuk do te qendroje 45-60 min.

7	• Rrjedhja e mushkrise automatike: 400 1/min	• Nuk ka shenime per rrjedhjen e mushkrise.	• Nese rrjedhja eshte me e ulet, perdoruesi do te kete veshtiresi ne fiymemarrje.
8	• Zhurma e filikaqes, minimum: 90 decibel - dBA	• Nuk ka shenime.	• Nese zhurma eshte me e ulet, perdoruesi rrezikohet te mbetet pa ajer rezerve per vete-evakuim dhe mund t'i kushtoje me jete.

baze te dokumenteve tenderuese te paraqitura nga ky OE, verehet qarte se i njejti ka paraqitur dy modele ne katalog: X-PRO - qe nuk eshte moster, dhe, Fenzy Aeris Type 2 - qe eshte moster. Per modelin e dyte, Fenzy Aeris Type 2, OE ka paraqitur dy katalogun, njerin origjinal - te punuar nga prodhuesi, dhe tjetrin te punuar nga vet OE (duke aluduar se katalogu i vete punuar eshte deklarate nga prodhuesi, dokument i cili nuk eshte i vertetuar nga prodhuesi) - me **9**'rast i pershtat te gjitha specifikimet teknike sipas kerkeses se AK-se.

Rrjedhimisht, mbi bazen e te lartcekurave, rezulton se nje oferte e tille duhet te konsiderohet si e papergjegjshme dhe OE ne fjale duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

PRETENDIMIANKIMOR 3:

A . OFERTA E OE "A&V COLLECTION" NUK I PERMBUSHE SPECIFIKACIONET TEKNIKE TE PERCAKTUARA NE DOSJEN E TENDERIT

s qasjes ne dokumentet tenderuese te OE "A&V Collection", OE Ankues ka verejtur se i njejti nuk i permbushe kriteret lidhur me specifikacionet teknike te percaktuara si ne Aneksin 1 te Dosjes se Tenderit.

ashtu, pervep qe ky OE nuk permbushe kriteret esenciale, i njejti ka ofruar katalog te dyshimte per sistemin mbajtes. OE nuk ka ofruar katalogun per bombole dhe maske sip eshte kerkuar ne piken 9.1/C te cilat nuk permbajne pershkrim te karakteristikave te pajisjeve, sip kerkohet ne specifikimet teknike (Aneksi 1) nga Dosja e Tenderit, por ka ofruar manuale per perdorim te diet nuk permbushin as 50 % te kerkeses nga AK, per te cilat arsye edhe duhet te shpallet si OE i papergjegjshem per kete aktivitet te prokurimit dhe te eliminohet.

Me konkretisht, ne tabelen ne vijim kemi paraqitur Specifikat teknike te kerkuara nga AK (ne anen e majte) dhe oferten e dorezuar nga OE "A&V Collection" (ne anen e djathte):

	cifikimi teknik i Autoritetit traktues	cifikimi teknik i Operatorit nomik	

	Sistemi I Mbajtjes	Fenzy Aeris Type 2	asojat qe rrjedhin nga dallimet ne mes te produkteve te kerkuara dhe te ofruara
1.1	Rripat e shpatullave duhet te jene te veshur me gome ose nga materiali zjarrdurues retardante; dhe, Te jene rezistente ndaj gerryerjes dhe shpimit, si dhe ndaj ndaj kimikateve dhe zjarrit, dhe te jene te punuara me aramid.	• Duke u bazuar ne broshuarat e prodhuesit te paraqitura ne web-faqe, dhe jo katalogun e manipuluar nga OE, rrypat nuk jane rezistent ndaj gerryerjes, shpimit dhe materieve kimike apo acideve.	e Ne rast se rrypat nuk sigurojne rezistencen e kerkuar, te njejtit mund te keputen lehte apo te shkaterrohen ose pelcasin nga acidi, dhe ne kete menyre rrezikojne jeten e personave qe i bartin keto pajisje.
1.2	Dimenzionet maksimale (H x W x D): (590 - 630) x (280 - 410) x (70-220) mm	k ka shenime per dimenzione, as ne faqen zyrtare te prodhuesit.	
1.3	• Rrjedhja e mushkrise automatike: 400 1/min	• Nuk ka shenime per rrjedhjen e mushkerise.	• Nese rrjedhja eshte me e ulet se sa eshte kerkuar nga AK, perdoruesi mund te kete veshtiresi ne frymemarrje.
1.4	ırma e filikaqes, minimum: 90 decibel -dBA	uk ka shenime per nivelin e zhurmes se filikaqes.	• Nese zhurma eshte me e ulet, perdoruesi rrezikon te mbetet pa ajer rezerve i cili nevojitet per vete-evakuim.
1.5	esioni nominal i fazes se pare: 7.5 bar	• Nuk ka shenime ne katalogun e prodhuesit.	® Presioni nominal eshte tejet i rendesishem qe reduktimi nga 300 ne ~ afersisht 1 bar te jete i pershkallezuar. Ne rast se deshton reduktuesi i presionit te larte, mushkeria automatike te jete preventive.

	1.6	• EN 14593 (MED) 2014/90/EU.	Nuk posedon aprovimin EN 14593. k dihet cilin MED standard posedon.	• Aprovimi EN 14593 specifikon kerkesat nimale per pajisjet e frymemanjes me ajer te komprimuar me valvule automatike dhe maske, si pajisje mbrojtese e memarrjes. Do te thote se kjo pajisje as minimalisht nuk permbushe standardet e kerkuara per siguri ne pune. Ky standard e rrit koston e produktit, dhe per kete arsye pajisja ka qene me cmim me te ulet. Mungesa e deshmive per standardin MED nenkupton se produkti i ofertuar nuk eshte ne perputhje me direktiven 2014/90/EU te	
				Parlamentit dhe Keshillit Europian. Te gjitha keto kerkesa e rrisin shume koston e produktit, dhe gjithashtu kane ndikim ne sigurine dhe jeten e zjarrfikseve.	
		2. ('IUNI)I 1 A.IUIT	SAI EK Cylinder 7 1,	pjat <[e i i jedhin nga dalliuicf lie nies Ic piodiikleve le kerkuar dhe alyrc te olVuar	
	2.1	Duhet te jete e pajisur me valvule sigurie te rrjedhes se tepert. • Te jete rezistent ndaj goditjeve, substancave kimike dhe i lehte per tu pastruar.	• Cilindri i oferluar nga OE nuk posedon shenime se ka bombole me valvule sigurie te rrjedhes se tepert. • Bomobola nuk posedon deshmi se eshte rezistente ndaj substancave kimike.	• Mungesa e valvules se sigurise te rrjedhes se tepert rrezikon jeten e perdoruesit dhe personave afer tije edhe ule koston e bomboles. • Mos-rezistenca ndaj goditjeve dhe substancave kimike ndikon qe cilindri te shkaterrohet ose te pelcase nga acidi.	

2.2	Testuar ne perputhje me standardet 97/23/EC	uk posedon standardin e kerkuar EN 97/23/EC, as	• Standardi EN 97/23/EC eshte zevendesuar me 15 maj 2014 me standardin e ri 2014/68/EU. ICy standard eshte i domodoshem qe te gjitha pajisjet me presion t'i nenshtrohen testit me presion. Pajisja pa kete standard rrezikon jeten e perdoruesit te pajisjes.
2.3	• Vellimi i ujit: 6.8 litra	ka ofertuar me bombole e cila eshte me e madhe dhe vellimi i ujit eshte 7.0 litra dhe ka tejkaluar kerkesen e AK.	adhesia e bomboles ndikon ne peshe dhe dimenzione. Per zjarrfikesin pesha e ulet ka rendesi qe mos te ndikoje ne lodhjen e tij.
2.4	• Kohezgjatja e punes minimum: 45 - 60 minuta	k posedon shenime per kohezgjatje te punes.	
2.5	Pesha maksimale: 2.5 - 3.5 kilogram	mbola tejkalon peshen e kerkuar 4.5 kg.	Pesha epajisjeve eshte faktor shume i rendesishem per zjarrfikesin, ne kete rast, pesha e tepruar shkakton lodhjen dhe ule efikasitetin e

Ne baze te dokumenteve tenderuese te paraqitura nga ky OE, verehet qarte se i njejti nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar, sip eshte kerkuar ne piken 9.1 & 9.2 te Dosjes se Tenderit. Po ashtu, OE ne fjale nuk ka dorezuar dokumentet/deshmite e tjera te nevojshme lidhur me sistemin e mbajtjes, cilindrin e ajrit dhe masken.

OE ne fjale ka paraqitur oferten e Kompanise Honeywell dhe autorizimin e prodhuesit, duke aluduar se Kompania Turke Atlas KKD eshte diler i autorizuar i prodhuesit Honeywell. Ne anen tjeter, nuk ka paraqitur asnje deshmi qe Kompania Atlas KKD bashkepunon me Kompanine Honeywell, ne menyre qe Atlas KKD te mund te leshoje autorizime ne emer te prodhuesit Honeywell.

Rrjedhimisht, mbi bazen e te lartcekurave, rezulton se nje oferte e tille duhet te konsiderohet si e papergjegjshme dhe OE ne fjale duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Prandaj, duke u bazuar ne agumentet dhe shkeljet e elaboruara me larte, OE ""M.S. Medicom", me respekt, kerkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe te merr kete:

AKTVENDIM

I. **APROVOHET** Ankesa e OE "M.S. Medicom" si e bazuar;

II. **ANULOHET** Vendimi gjegjesisht Letra Standarde per tenderuesin e eliminuar si dhe Vendimi i AK i dates 14.10.2020 dhe lenda te kthehet ne rivleresim dhe rivendosje.

8. Demet material

OE "M.S. Medicom" do te pesoje deme jashtezakonisht te medha si pasoje e shkeljeve ligjore te kryera nga ana e AK. Keto deme perfshijne fitimin e humbur i cili do te realizohej po qe se AK do te vepronte ne perputhje me dispozitat e LPP-se, demet qe do te shkaktoheshin ne raport me prodhuesit dhe partneret me te diet OE ka vendosur te konkurroje ne kete procedure tenderuese, demtimi i reputacionit afarist ne tregun kosovar dhe me tutje, si dhe deme tjera materiale dhe jo materiale. Rrjedhimisht, OE "M.S. Medicom" do te detyrohet te veproje ne mbrojtje te interesave te tij ekonomike duke kerkuar kompensimin e plote te demeve te shkaktuara.

Kërkesat :

a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.

b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit *para publikimit të dhënies së kontratës.*

c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku në tremujorin e fundit *para publikimit të dhënies së kontratës.*

Dokumentet dëshmuese për pranueshmëri :

a. **Një deklaratë e shkruar nën Betim**, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, **Aneksi 2** (Origjinal).

b. **Vërtetimin nga Administrata Tatimore** (kopje), *duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fitues**, para publikimit të dhënies së kontratës.*

c. **Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike** (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), *duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fitues**, para publikimit të dhënies së kontratës.*

Kërkesat :

a. **Certifikatë e regjistrimit të biznesit**, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.

   Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës.

b. **Regjistrimi për numër fiskal** të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës) *për kompanitë vendore).*

c. **Deklarues i TVSH-së**, *(për kompanitë vendore).*

dokumentet dëshmuese për përshtatshmëri profesionale:

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- (kopje).

b. Certifikatën me numër fiskal (kopje).

c. Certifikata e TVSH-së (kopje).

Kerkesa

Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve te fundit jo me pak se 800,000.00 €.

Dëshmi e kërkuar dokumentare :

a. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur, ose Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për kompanitë vendore.

Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

a. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kete së paku 2 kontrata me furnizime te paisjeve te siguris ne institucionet e sigurise ne Kosove..

b. Operatoret ekonomik duhen të dorëzojnë **Autorizim nga prodhuesi ose përfaqësuesi - dileri i tij për shitje të paisjeve**. Operatori Ekonomik duhet te dëshmoi se është i autorizuar nga prodhuesi - dileri i autorizuar i prodhuesit për shitjen **e paisjeve me të cilat ofertojnë** me titull dhe nr. Te Prokurimit të projektit në fjalë),

c. Operatoret ekonomik bashkë me ofertë duhen të dorëzojnë **katalog** për pajisjen, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të pajisjeve, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1) nga Dosja e tenderit.

d. Operatoret ekonomik të dorëzojnë **mostrën,** në Zyrën e Prokurimit ne Agjencionin e Menaxhimit Emergjent në pajtueshmëri me specifikat teknike në këtë DT (Aneksi – 1) para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit

e. Prodhuesi ose dileri i autorizuar duhet te jete i certifikuar me standardin **ISO 9001:2015**

Dëshmitë e kërkuara:

f. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën, dhe **duke i bashkëngjitur dëshmi per kryerjen e furnizimve** (kopje) të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve.

g. Autorizim nga prodhuesi ose perfaqesuesit/dileri i autorizuar i prodhuesit për shitjen e produkteve qe ofroni - origjinal /skanuar

h. **Katalogë për pajisjen e kërkuara.**

i. **Mostrën për paisjen e kërkuar.**

j. **Certifikatat e ISO 9001:2015** nga prodhuesi ose dileri i autorizuar

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

DEKLARATE komisioni per vleresim. ek/aminim dhe krahasim te ofertave te tenderit ne ba/e te LPP, Nenit 59 si dhe kritereve ne DT dhe Aneksit Nr. I te 1)1 ka shqyrtuar dokumentacionin e operatoreve ekonomik ofertues si dhe mostrat e derguara. dhe konstaton se te gjith operatoret ekonomik kan ofertuar konfrom kritereve te dosjes se tenderit dhe ankesit nr.I por duke pasur parasysh kriterin ne dosjen e tenderit dhe LPP ymimi me i lire komisioni konstaron dhe rekomandon per dlienie te kontrates operatorin ekonim „ Fit ini Bilalli B.I Dardani X" me qmiimin me te lirte ofertes.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. PERGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES "N,T.SH. MEDICOM "

Republika e Kosoves

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria -1 lada-Government

Minis! via e Punevc te Brendslime Ministarstvo l nutrasnjih Post ora

Ministry of Internal A ff airs

Agjencia e Menaxhimit Emergent / Agencija Emergentnog Upravljanja

Emergency Manage Republika Kosovo-Republic of Kosovo

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

pas Nenit 43. ~ dhe 44.2 te Rregullave dhe l 'dhezuesit Operativ le Prokurimit Publik

Titulli i kontrates i dhene nga autoriteti kontraktues: ..Funizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajerit"

Numri i aktivitetit te prokurimit:

Nr. i prokurimit	21432700-20-4902-1-1-1
Nr. i brendshem	**214/20/17/111**

Nr.	Emri dhe adresa Operatoreve Fkonomik pjesemarres	Viera totale e ofertave[2]
1.	A & V Collection (Sahit Makiqi B.l.)	567.580.00 Euro
2	N.T.SH."M.S.MEDICOM"	611.598.72 Euro
a.	Sodex Group SH.P.K.	692.801.60 Euro
4	**Fitim R. Bilalli B.l. (DardaniX)**	**559,202,00 Euro**
5	ALBKOS SAFETY SH.P.K.	573.999.20 Euro

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Agjencia e Menaxhimit Emergjent - AME **shperblen** me kontrate ..Fitim R. Bilalli B.l. (DardaniX)" ne vlere totale te ofertes **559,202,00 Euro,** t^mimi me i lire i pergjegjshem

Data: ^[DiOcOa

[1] Te rapoitohet ne v'do document apo **kerkese ne lidhje me aktivitetin e prokurimit.**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Lulzim Bajrami

ment Agency

Konstatimi per pretendimin Ankimore-

Pretendimet Ankimore te OE Medicom se eshte shkelur neni 59 i LPP-se se OE i rekomanduar per kontrat **"N.T.P. Dardani X"** eshte i Pa pergjeshem. Eksperti shqyertues mendone se eshte plotësisht i qëndrueshëm pretendimi sepse, AK i AME-se nuk ka dëshmi se ka bere vlerësim teknik te ofertave por vetëm ne baze te çmimit me te ulte e ka rekomanduar per kontrate dhe te gjithë OE tjerë qe kane ofertuar i ka trajtuar si OE te pasukseshem.

Ne baze te nenit 59 te LPP-se AK i AME-se duhet te beje vlerësim te ofertave ne përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 dhe kritereve te përcaktuar ne Njoftimin per kontrate ka mundur te kërkoj sqarime lidhur me specifikimet teknike dhe dokumentet tjera te pa qarta.

Eksperti shqurtues duke e u bazuar ne pretendime ankimore te OE Ankues -kam shqyrtuar Aktivitetin e Prokurimit lidhur me kete tender e konstatoj se AK i AME nuk ka dëshmi se ka bere vlerësim teknik te asnjërit nga OE qe kane ofertuar ne tender qe kjo konsiderohet shkelje e rende e LPP-se pasi te shpallet nje tender me vlere 800,000.00 euro e fare te mos beje vlersime teknike kjo shifet qarte pa përgjegjësin e njesis se kerkes po edhe te AK tersi . (Ne kete konstatim bazohna ne dokumentet qe janë te ngarkuara ne E-prokurim nuk ka vlerësim teknik)

Eksperti Shqyrtues mendon se edhe pretendimet tjera te OE Ankues Medicom janë te qëndrueshme sepse AK i AME-se duhet te beje vlerësim te ofertave ne përputhje me RRUOPP dhe ne përputhje me LPP_ne e jo te mundohet te realizoj nje projekt prej 800,000.00 euro pa kurrfarë vlersimi teknik te ofertave kete dëshmohet se as ne raportin e vlersimit ne **hapin 8 te raportit te vlersimit** (e-prokurim) qe kërkohet te jepet nje vlerësim teknik -konstatim te ofertave per secilin OE nuk ka kurfar konstatimi , shënimi -vlersimi.

Duke u bazuar ne pretendimet Ankimore dhe ne analizizimin e Aktivitetit te Prokurimit pretendimet e OE Ankues lidhur me vlersimin teknik eshte bazuar vetëm ne mostra dhe vetëm te nje pjese e dokumentacionit te ofertave e pretendimet nuk munde te merren krejtësisht te bazuara por eksperti mendon se AK duhet te vlerësoj separi ofertat administrativisht e tani teknikisht e pas vlersimit administrativisht dhe teknikisht te rekomandoj OE me çmim me te ulet.

Ne baze te Ligjit eksperti mendon se eshte përgjegjësi e AK – njesis se kërkesës qe te beje vlersimin e te gjitha ofertave ne përputhje me Aneksin 1 te Dosjes se tenderit dhe te nxjerr nje përfundim se cila kompani i ka plotësuar kërkesat teknik mandatori me se miri e atëherë te beje nje krahasim te ofertave qe eshte me e pershtatsheme edhe per nga çmimi e te rekomandoj per kontrate, e jo te mundohet ta heqë përgjegjësin nga vetja lidhur me kete projekt.

Ne baze te konstatimeve te cekura me larte se pretendimet ankimore janë te bazuar dhe tenderi duhet te kthehet ne piken zero te vlersimit qe njësia e kërkesës dhe njësia e prokurimit te bëjnë nje vlerësim teknik te ofertave duke u bazuar ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe ne sqarimet qe janë bere lidhur me kete Aktivitet te prokurimit, ne përputhje me nenin 59 dhe me nenin 72 te LPP_se te sigurojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve eksperti mendon se qdo rekomandim tjetër nga eksperti por edhe nga paneli shqyrtues do te biem ne lajthitje te njësisë se kërkesës se AME-se .

Gjithashtu ne kërkesën për Rishqyrtim qe kam analizuar une si ekspert AK i AME-se nuk ka rishqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues, ku ka pas mundësi AK ti korrigjoj lëshimet qe janë bere gjate fazës se vlerësimit.

Ne konstatimin përfundimtar eksperti shqyertues mendon se lënda **"Funizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajërit"** me nr. të prokurimit: **21432700-20-4902-1-1-1**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues – Agjencia e Menaxhimit Emergjent** duhet te kthehet ne rivlerësim ne piken zero te vlersimit te ofertave. Ndersa kërkoj nga Paneli Shqyrtues qe Ankesen te merret e bazuar e te kërkoj nga AK-ja qe te anulohet njoftim vendimi mbi dhënien te datës 08.10.2020 e tenderi te kthehet ne Rivlerësim pasi nuk ka vlerësim teknik te ofertave nga njësia e kërkesës.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE "N.T.SH. M.S.MEDIKOM"B.I, për Tenderi me titull; **"Funizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajërit",** te anulohet njoftim vendimi mbi dhënien e lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe ankesa te merret si e bazuar.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia e Menaxhimit Emergjent**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - **OE "N.T.SH. M.S.MEDIKOM"B.I,**